

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 10.1.2022**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE GRUPIT  
*JONES INTERNATIONAL*, PËR FORCIMIN E SIGURISË KIBERNETIKE TË  
INFRASTRUKTURËS KRITIKE PËR SHQIPËRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe grupit *Jones International*, për forcimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës kritike për Shqipërinë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE *JONES GROUP INTERNATIONAL*, PËR FORCIMIN E SIGURISË**  
**KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURËS KRITIKE PËR SHQIPËRINË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe *Jones Group International*, një shoqëri e themeluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në vijim e referuar veçmas si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”),

*duke njohur* marrëdhëniet ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, memorandumin e bashkëpunimit ekonomik të vendosur ndërmjet SHBA-ve dhe Shqipërisë më 3 tetor 2020, si dhe memorandumin e mirëkuptimit të vendosur ndërmjet dy vendeve, më 13 qershor 2021, për bashkëpunim në sigurimin e informacionit, 5G të sigurt dhe rrjete të besueshme;

*duke njohur më tej* rëndësinë e sigurisë kibernetike vigjilente dhe gjithëpërfshirëse për asetet e infrastrukturës kombëtare të Shqipërisë, agjencitë e saj qeveritare dhe informacionin e qytetarëve të saj;

*me dëshirën* për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin ndërmjet dy palëve në fushën e sigurimit kibernetik dhe sigurisë së informacionit;

*me qëllimin* për të rritur aftësinë e sigurisë kibernetike dhe qëndrueshmërisë së operatorëve CII në Republikën e Shqipërisë;

*duke besuar* se një bashkëpunim i tillë do t’i shërbente interesave të përbashkëta të qeverisë shqiptare dhe qytetarëve të saj, dhe do të kontribuonte në zhvillimin e Shqipërisë në teknologjinë dhe burimet e sigurisë kibernetike,

*kanë rënë dakord* si më poshtë:

## Neni I

### Objektivi

1. Qëllimet e këtij memorandum mirëkuptimi (MM) janë forcimi i pozicionit të sigurisë kibernetike që i përkasin njësive qeveritare civile, sigurimit të informacionit dhe aftësive të mbrojtjes së qeverisë shqiptare e të agjencive të saj, zgjerimi dhe rritja e burimeve dhe e trajnimeve shqiptare të sigurisë kibernetike, si dhe promovimi i bashkëpunimit teknologjik në fushat me interes për qeverinë shqiptare, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe praktikat më të mira të SHBA-ve.

2. Palët, në bazë të kushteve të këtij MM-je dhe ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe politikave kombëtare në fuqi në vendin e secilës palë, bien dakord të forcojnë, të promovojnë dhe të zhvillojnë bashkëpunimin në sigurinë kibernetike dhe sigurimin, dhe mbrojtjen e informacionit.

## Neni II

### Fushat e bashkëpunimit

Çdo palë, në bazë të ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe politikave kombëtare në fuqi në vendin e tyre përkatës, do të përpiqet të bashkëpunojë në fushat e mëposhtme:

a) të kryejë vlerësime kibernetike gjithëpërfshirëse për çdo agjenci civile qeveritare, sipas prioriteteve nga ana e qeverisë shqiptare, dhe të hartojë plane të transformimit kibernetik për secilën agjenci, të pasuara nga zbatimi i këtyre planeve transformimi, në lidhje me skedulet dhe disponueshmërinë e burimeve të secilës ministri, në përputhje me Strategjinë Kombëtare Kibernetike;

b) të asistojë qeverinë shqiptare për të zhvilluar, zbatuar dhe operuar një Qendër Kombëtare të Operacioneve të Sigurisë Kibernetike (QOSK), për qeverinë shqiptare dhe agjencitë e saj, për të përfshirë zhvillimin e teknologjisë dhe ndërfaqeve të nevojshme, për të mbështetur monitorimin e aktivitetit të kërcënimit kibernetik në rrjetet e agjencive dhe informacionit;

c) dhënien e asistencës për krijimin e Qendrës Shqiptare të Ekselencës për Sigurinë Kibernetike në Tiranë, ku do të drejtohen programet sipas këtij memorandum dhe të punësojë, dhe të trajnojë burimet teknike shqiptare në mbështetje të rritjes afatgjatë të aftësive kibernetike të Shqipërisë; dhe

ç) çdo fushë tjetër bashkëpunimi në fushën e sigurisë kibernetike dhe sigurimit të informacionit për t'u rënë dakord reciprokisht nga palët.

## Neni III

### Autoriteti i caktuar

Autoriteti i caktuar përgjegjës për zbatimin e këtij MM-je do të jetë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ose çdo autoritet i autorizuar nga ky i fundit, dhe në emër të *Jones Group International* do të jetë filiali i saj në Shqipëri, *Jones Group Europe LLC*.

## Neni IV

### Lehtësimi i bashkëpunimit

1. Në vijim të kushteve të këtij MM-je dhe në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret dhe politikat kombëtare të zbatueshme në vendin e tyre përkatës, palët do të përpiqen të punojnë së bashku për të ndihmuar njëra-tjetrën, për të lehtësuar zbatimin e këtij MM-je.

2. Secila palë do të lehtësojë, në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret dhe politikat e saj kombëtare, hyrjen dhe daljen nga territori i saj të personelit, dhe pajisjeve të duhura të palës tjetër, sipas nevojës për kryerjen e aktiviteteve, projekteve dhe programeve sipas MM-së.

3. Secila palë do të lehtësojë, në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret dhe politikat e saj kombëtare, akses të shpejtë dhe efikas të personelit të palës tjetër që merr pjesë në aktivitetet bashkëpunuese sipas këtij MM-je, në zonat e saj gjeografike, institucionet, agjencitë, të dhënat, materialet përkatëse dhe specialistë individualë sipas nevojës për kryerjen e aktiviteteve.

Neni V  
**Ligji i zbatueshëm**

Për aktivitetet e përbashkëta dhe të gjitha çështjet e krijuara ose që lidhen me këtë memorandum mirëkuptimi gjen zbatim legjislacioni shqiptar.

Ky memorandum mirëkuptimi nuk do të krijojë efekte ligjore ndërmjet palëve. Palët bien dakord që në çdo bashkëpunim në të ardhmen mbi këtë projekt do të mbështetet në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas legjislacioni shqiptar.

Neni VI  
**Dispozita financiare**

Masat financiare, që do të mbulojnë shpenzimet për aktivitetet bashkëpunuese të ndërmarra brenda kuadrit të këtij memorandum mirëkuptimi, do të përcaktohen nga kontrata individuale të dakordësuara reciprokisht dhe të nënshkruara nga palët përkatëse.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave nga pala e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe *Jones Group International*, për forcimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës kritike për Shqipërinë.

Bërë në Tiranë, Shqipëri, në datën 11 janar, në vitin 2022, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

---

Znj. Belinda Balluku  
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

PËR *JONES GROUP INTERNATIONAL*

---

James L. Jones  
Gjeneral, USMC (në pension)  
President, *Jones Group International*